



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	23.02.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Gazmend Rushiti Menaxher i Zyrës së Prokurimit në QKUK
CC:	z. Nijazi Gashi Qendra Klinike Universitare e Kosovës.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Furnizimi me derivate të naftës"

I nderuari z. Rushiti

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Furnizimi me derivate të naftës" me numr prokurimi 701-12-008-121 ofron këtë:

OPINION

Ju si autoritet kontraktues Zyra Prokurimit – QKUK t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetim, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04-L/042.

Ar sy e t i m

Zyra e prokurimit në QKUK, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "Furnizim" të procedurës së hapur kontrata publike kornizë me nr. të prokurimit 701-12-008-121 me titull "Furnizimi me derivate të naftës", në Pjesën,

Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit të neni 7.1 i Dosjes së tenderit të Kërkesat mundësit teknike dhe /ose profesionale pika 4 Dokumentet e Kërkuara - ka kërkuar që Operatori Ekonomik ta ketë një pikë të shitjes të karburanteve më se largu 7 km largësi nga qendra e ndërtesës së QKUK-së (arsye është që në mungesë të rezervuarit dhe pompës për mbushje me naftë të Automjeteve mos të kemi shpenzime të mëdha për shkuarjen e automjeteve të mbushen me naftë dhe benzinë) të dëshmohet që ka një pikë shitje në këtë afërsi (deklarata me shkrim nga kompania se ku gjendet pika me e afërte shitës nga QKUK) - njëri nga anëtarët e grupit në rast se janë grup i Operatorëve Ekonomik, nga kjo rrjedh se departamenti prokurimit ka bërë diskriminim territorial gjë që paraqet shkelje të nenit 7 pika 4 LPP-së 04/L-042.

Me respekt!

